

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit:

Integriteti zgjedhor, qëndrueshmëria e medias dhe ndërgjegjësimi publik

Vlerësim për Objektivat I dhe IV në 6 muajt e parë të zbatimit



BIRN

Balkan
Investigative
Reporting
Network

ALBANIA

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit:

Integriteti zgjedhor, qëndrueshmëria e medias
dhe ndërgjegjësimi publik

Vlerësim për Objektivat I dhe IV në 6 muajt e parë të zbatimit

Mars 2026

Botuar nga: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri

Rruga Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë, Shqipëri

<http://birn.eu.com/>

Autorë: Megi Reçi

Daniel Prroni

© 2026 Balkan Investigative Reporting Network Albania (BIRN Albania)



Versioni elektronik i këtij botimi është i disponueshëm nën licencën Creative Commons Attribution-NonCommercial-ShareAlike 4.0. Ju mund ta kopjoni, shpërndani dhe transmetoni botimin, si dhe ta rimodeloni apo përshtasni, me kusht që përdorimi të jetë vetëm jofitimprurës, që t'i atribuoni në mënyrë të duhur botimit dhe që ta shpërndani nën të njëjtën licencë. Për më shumë informacion, vizitoni faqen zyrtare të Creative Commons: <http://creativecommons.org/licenses/by-nc-sa/4.0/>.

Ky raport është hartuar për BIRN Albania me mbështetjen e FCDO nëpërmjet Ambasadës Britanike në Tiranë. Gjetjet e këtij raporti janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Ambasadës Britanike në Tiranë.



Partnership | Progress | Prosperity

PËRMBAJTJA

	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1.	KONTEKSTI	9
2.	QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT	12
	2.1 Fusha e vlerësimit	13
	2.2 Qasja metodologjike e monitorimit	13
	2.3 Burimet e të dhënave dhe klasifikimi i progresit të zbatimit	16
3.	VLERËSIMI I ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE I DHE IV TË STRATEGJISË	17
	3.1 Kuadri i masave të parashikuara në Objektivat I dhe IV	18
	3.2 Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe koordinimin	21
	3.3 Progresi fillestar i zbatimit të masave	24
	Progresi fillestar në masat që lidhen me integritetin e proceseve zgjedhore	26
	Progresi fillestar në masat që lidhen me median, edukimin mediatik dhe ndërgjegjësimin publik	28
	Masat për të cilat nuk ka nisur ende zbatim	29
	3.4 Gjetjet e monitorimit sipas masave	31
4.	KONKLUZIONE	39
5.	REKOMANDIME	42

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Volumi i masave sipas afateve	19
Figura 2: Numri i masave sipas tipologjisë së tyre	19
Figura 3: Institucionet e renditura sipas numrit të masave për të cilat janë përgjegjëse	22
Figura 4: Përcaktimi i zyrtarëve/njësive përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë	23
Figura 5: Shpërndarja e masave sipas statusit të zbatimit	25
Figura 6: Progresi i zbatimit sipas institucioneve përgjegjëse	25
Figura 7: Statusi i zbatimit sipas tipologjisë së masës	26

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Treguesit sipas tipologjisë së masave të Strategjisë	14
Tabela 2: Statusi i zbatimit të masave të Objektivit I “Ngritje dhe konsolidim i kapaciteteve institucionale për të parandaluar, zbuluar dhe analizuar ndërhyrjet e huaja në fushatat zgjedhore”	32
Tabela 3: Statusi i zbatimit të masave të Objektivit IV “Mbrojtja dhe forcimi i lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit publik kundër dezinformimit”	36

Përmbledhje ekzekutive

Strategjia Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030 u prezantua si përgjigjja institucionale e Shqipërisë ndaj një problemi gjithnjë e më të dukshëm, si manipulimi i informacionit, ndikimi i aktorëve të huaj dhe dobësitë e vetë institucioneve përballë dezinformimit. Raporti vlerëson gjashtë muajt e parë të zbatimit të Objektivave I dhe IV të Strategjisë, të cilat lidhen me mbrojtjen e proceseve zgjedhore, transparencën e financimeve politike, forcimin e medias dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik. Në thelb, ky vlerësim fillestar përpiqet të kuptojë nëse Strategjia po shndërrohet në veprim konkret.

Gjetja kryesore është se, gjatë periudhës së monitorimit, Strategjia ka prodhuar më shumë planifikim sesa rezultate. Nga 28 masat e analizuara, asnjë nuk rezultoi e zbatuar plotësisht. Për shumicën e tyre (rreth 64%) nuk ka progres të dukshëm ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të kuptuar nëse ka patur ecuri. Vetëm 36% e masave janë në faza fillestare planifikimi ose zbatimi.

Të dhënat sugjerojnë se, gjatë gjashtëmujorit të parë, institucionet janë përqendruar te masat më të arritshme për t'u vënë në zbatim, të tilla si trajnime, takime koordinuese, bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë dhe përmirësime të përgjithshme të kapaciteteve. Ndërkohë, masat më të ndërlikuara që kërkojnë më shumë koordinim, burime dhe përgjegjësi politike, të tilla si ndryshime ligjore, krijimi i strukturave të reja, sisteme digjitale për transparencën e financimeve politike apo mekanizma të qëndrueshëm monitorimi, kanë mbetur kryesisht pezull.

Në fushën e medias dhe edukimit mediatik, raporti vëren se ekziston një vetëdije relativisht më e madhe për rëndësinë e gazetarisë së pavarur, verifikimit të fakteve dhe aftësive digjitale të qytetarëve. Megjithatë, këto prioritete nuk janë shoqëruar ende me politika konkrete, financime apo programe të qëndrueshme. Për shembull, janë parashikuar trajnime për gazetarët, mbështetje për organizatat e shoqërisë civile dhe integrimi i edukimit mediatik në shkolla, shumica e të cilave mbeten ende për t'u zbatuar.

Një nga dobësitë më të dukshme të evidentuara në raport është mungesa e një mekanizmi të qartë për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë. Komisioni parlamentar që hartoi Strategjinë e mbylli mandatin e tij sapo strategjia u miratua dhe nuk u zëvendësua me një mekanizëm të ri monitorimi. Megjithatë Strategjia parashikon miratimin e një Plani Veprimi nga Këshilli i Ministrave brenda vitit 2025 dhe krijimin e një strukture të dedikuar për koordinimin e saj, deri në publikimin e raportit asnjëri prej këtyre mekanizmave nuk është ngritur, duke penguar fillimin e punës për një pjesë të institucioneve përgjegjëse (70% e institucioneve nuk kanë nisur zbatimin) dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në ecurinë e pamjaftueshme të zbatimit. Si rezultat, Strategjia ka mbetur pa një “qendër graviteti” institucionale.

Zbatimi i Strategjisë ka nxjerrë në pah edhe mangësi në fazën e hartimit të saj, pasi disa institucione përgjegjëse kanë argumentuar se masat për të cilat janë ngarkuar bien jashtë kompetencave të tyre ligjore apo fushës së veprimtarisë, duke sugjeruar se ndarja e përgjegjësive institucionale nuk ka qenë gjithmonë e qartë dhe mund të ndikojë në zbatueshmërinë e disa masave të Strategjisë.

Në tërësi, raporti paraqet një Strategji që po ecën ngadalë dhe pa drejtim të qartë në praktikë. Gjetjet sugjerojnë se aftësia e institucioneve për të ndërtuar mekanizma funksionalë dhe të qëndrueshëm përballë dezinformimit dhe ndërhyrjeve të huaja mbetet ende e brishtë dhe, nëse ritmet aktuale vijojnë, ka gjasa që Strategjia të mbetet një angazhim pa rezultate të prekshme.

1.KONTEKSTI

Manipulimi dhe ndërhyrja e huaj në hapësirën e informacionit është shndërruar në një nga format kryesore të kërcënimeve hibride ndaj demokracive moderne. Përhapja e qëllimshme e dezinformimit, propagandës dhe manipulimit të informacionit përpiqet të ndikojë opinionin publik, të çënojë besimin tek institucionet demokratike dhe të dobësojë proceset vendimmarrëse.

Në dekadën e fundit, mjedisi informativ, veçanërisht ai digjital, është kthyer në një fushëbetejë të rivalitetit gjeopolitik, ku aktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë përdorin teknologjinë për të amplifikuar narrativat manipuluese dhe për të ndikuar proceset politike dhe shoqërore. Në këtë kontekst, në nivel ndërkombëtar, përfshirë Bashkimin Evropian dhe NATO-n, janë përshkallëzuar përpjekjet për të zhvilluar politika, mekanizma monitorimi dhe instrumente bashkëpunimi për identifikimin dhe kundërveprimin ndaj këtyre kërcënimeve.

Në Shqipëri, [shqetësimet](#) për ndërhyrjet e huaja dhe përhapjen e dezinformimit janë rritur paralelisht me këto zhvillime globale, por edhe si pasojë e faktorëve të brendshëm që lidhen me cenueshmërinë e mjedisit informativ dhe institucional. Koordinimi i kufizuar ndërinstitutional, kapacitetet e pamjaftueshme dhe mungesa e një mekanizmi të pavarur monitorimi kanë [kufizuar](#) aftësinë për të adresuar këto fenomene.

Gjithashtu, peizazhi mediatik në vend vuan nga një përqendrim i lartë i pronësisë, mungesë transparence në financimin e mediave dhe kapacitete të kufizuara për verifikimin profesional të informacionit. Shumë media nuk kanë politika të qarta editoriale apo respektim të standardeve etike të gazetarisë.

Në të njëjtën kohë, mungesa e rregullimit të veprimtarisë së platformave digjitale ka mundësuar përhapjen e shpejtë të përmbajtjeve të paverifikuara, pa përgjegjshmëri. Këta faktorë, të kombinuar me nivele të ulëta të edukimit mediatik dhe digjital, besim të kufizuar të publikut tek institucionet dhe një mjedis politik tejet të polarizuar, kanë krijuar një terren të cenueshëm ndaj përhapjes së dezinformimit si nga aktorë vendas, ashtu edhe nga aktorë të huaj.

Anëtarësia në NATO dhe procesi i integritimit në Bashkimin Evropian e vendosin vendin gjithashtu brenda dinamikave më të gjera të përplasjeve gjeopolitike në hapësirën e informacionit. [Studime](#) tregojnë se aktorë të huaj, duke përfshirë Rusinë, Kinën dhe Iranin, i kanë shfrytëzuar këto dobësi për të promovuar narrativa që përpiqen të nxisin ndasi dhe keqinformim në opinionin publik. Megjithatë, nuk ka prova të qarta mbi masën në të cilën këto përpjekje kanë ndikuar drejtpërdrejt në formësimin e opinionit publik për çështje të ndjeshme politike dhe shoqërore.

Për të koordinuar veprimet institucionale ndaj këtyre shqetësimeve, në vitin 2024 në Parlament u krijua Komisioni i Posaçëm kundër Dezinformimit dhe Formave të tjera të Ndërhyrjes së Huaj në proceset demokratike të vendit. Nevoja për të hartuar një qasje institucionale ishte e qartë, megjithatë krijimi i këtij komisioni u kritikua nga organizatat e shoqërisë civile dhe ato të medias. [Kritikat](#) cekën shqetësimet për ndikimin e mundshëm të kësaj nisme mbi lirinë e shprehjes, për shkak të mandatit të paqartë, rrezikut të politizimit të procesit dhe frikës se komisioni mund të

instrumentalizohej për të kufizuar lirinë e medias. Sipas kritikëve, shumica e dezinformimit në Shqipëri buron nga aktorë vendas dhe mund të trajtohej përmes institucioneve ekzistuese.

Ky komision u ngarkua me koordinimin dhe mbikëqyrjen e përpjekjeve institucionale për adresimin e dezinformimit dhe ndikimeve të jashtme në hapësirën informuese dhe politike të Shqipërisë. Në kuadër të mandatit të tij, komisioni hartoi Strategjinë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030 (në vijim “Strategjia”), e cila u miratua me Ligjin nr. 47/2025, datë 3 korrik 2025.

Strategjia synon të vendosë një kornizë të koordinuar institucionale për identifikimin, parandalimin dhe adresimin e ndërhyrjeve të huaja keqdashëse në hapësirën e informacionit, duke përfshirë dezinformimin dhe forma të tjera të manipulimit të informacionit. Në mënyrë më të gjerë, ajo synon të garantojë mbrojtjen e interesave kombëtare dhe të forcojë qëndrueshmërinë e proceseve demokratike përballë këtyre kërcënimeve.

Strategjia ka katër objektiva kryesorë që adresojnë dimensione të ndryshme të fenomenit:

OBJEKTIVI I trajton forcimin e kapaciteteve institucionale për të parandaluar, zbuluar dhe analizuar ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore. Ai përfshin përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mekanizmave të monitorimit të zgjedhjeve, rritjen e transparencës dhe mbikëqyrjes së financimeve politike, si dhe forcimin e përgjegjësisë dhe koordinimit ndërmjet institucioneve publike dhe aktorëve privatë për parandalimin e ndërhyrjeve të huaja.

OBJEKTIVI II synon forcimin e sigurisë kombëtare përmes rritjes së kapaciteteve për zbulimin e hershëm, identifikimin dhe reagimin ndaj ndërhyrjeve të huaja hibride. Ai përfshin përmirësimin e koordinimit ndër-institucional, mbrojtjen e infrastrukturës kritike, zhvillimin e komunikimit strategjik me publikun, forcimin e kapaciteteve kibernetike dhe zgjerimin e bashkëpunimit me sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht NATO-n dhe Bashkimin Evropian.

OBJEKTIVI III ka për qëllim mbrojtjen e ekonomisë kombëtare dhe sektorëve strategjikë nga ndërhyrjet e huaja, përmes forcimit të mekanizmave ligjzbatues për monitorimin dhe kontrollin e kapitaleve në ekonomi. Ai përfshin gjithashtu adresimin e kërcënimeve ndaj sektorëve kritikë dhe sistemit financiar, me qëllim ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe parandalimin e ndikimeve keqdashëse.

OBJEKTIVI IV parashikon mbrojtjen dhe forcimin e lirisë së shprehjes dhe të medias, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik përballë dezinformimit. Ai përfshin zhvillimin e kapaciteteve të mediave të pavarura dhe mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile, promovimin e informacionit të besueshëm dhe rritjen e edukimit mediatik dhe aftësive digjitale të qytetarëve për të forcuar rezistencën shoqërore ndaj dezinformimit.

2. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

2.1 Fusha e vlerësimit

2.2 Qasja metodologjike e monitorimit

2.3 Burimet e të dhënave dhe klasifikimi
i progresit të zbatimit

2.1 Fusha e vlerësimit

Ky raport përqendrohet në vlerësimin e zbatimit të Objektivit I dhe Objektivit IV të Strategjisë gjatë 6-mujorit të parë të zbatimit të saj. Në mënyrë të veçantë, analiza shqyrton hapat e ndërmarra në drejtim të forcimit të integritetit të proceseve zgjedhore, transparencës së financimeve politike dhe koordinimit institucional për parandalimin e ndërhyrjeve të huaja, si dhe masat për mbështetjen e lirisë së medias, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe forcimin e qëndrueshmërisë shoqërore ndaj dezinformimit. Objektivat II dhe III trajtohen në një raport të veçantë monitorimi, i cili analizon dimensionin e sigurisë kombëtare, mbrojtjen e ekonomisë dhe sektorëve kritikë nga ndërhyrjet e huaja.

Vlerësimi fokusohet në hapat fillestarë institucionalë dhe progresin në krijimin e mekanizmave të zbatimit dhe nuk synon të masë ndikimin afatgjatë të Strategjisë në mjedisin informativ apo në qëndrueshmërinë demokratike.

Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një vlerësim të ecurisë së zbatimit të masave të parashikuara në Strategji, si dhe të analizojë nivelin e zhvillimit të infrastrukturës institucionale për zbatimin e tyre gjatë gjashtë muajve të parë pas miratimit të ligjit.

Raporti vlerëson zbatimin e 28 masave të parashikuara në dy (nga katër) objektivat e Strategjisë:

- Objektivi I: Ngritja dhe konsolidimi i kapaciteteve institucionale për të parandaluar, zbuluar dhe analizuar ndërhyrjet e huaja në fushatat zgjedhore;
- Objektivi IV: Mbrojtja dhe forcimi i lirisë së shprehjes dhe medias, si dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe aftësive të qytetarëve për të identifikuar dhe rezistuar ndaj dezinformimit.

Edhe pse shumica e masave kanë afate zbatimi që vijnë deri në vitin 2030, ky monitorim i hershëm ka për qëllim të sigurojë një pasqyrë fillestare të situatës, të identifikojë problematikat potenciale dhe të vendosë bazat për fazat e mëtejshme të monitorimit, kur niveli i zbatimit pritet të jetë më i përparuar dhe me rezultate të matshme.

2.2 Qasja metodologjike e monitorimit



Monitorimi është mbështetur në një qasje të strukturuar të bazuar në tipologjinë e masave të Strategjisë dhe në tregues të përshtatur për vlerësimin e progresit institucional për secilën prej tyre.


Për kryerjen e monitorimit u zhvillua një set treguesish specifike (shih Tabelën 1) për secilën masë të parashikuar në Strategji, të përshtatur me tipologjinë e saj dhe kompetencat e institucioneve përgjegjëse për zbatimin.

Tipologjia e masave të monitoruara u kategorizua në:


- hartimin ose rishikimin e legjislacionit parësor dhe dytësor;
- forcimin e kapaciteteve institucionale përmes trajnimeve, procedurave dhe burimeve administrative;
- zhvillimin e fushatave publike ndërgjegjësuese;
- integrimin e sistemeve elektronike dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT) në proceset institucionale të punës;
- strategji dhe masa operacionale;
- masa institucionale.

Tabela 1: Treguesit sipas tipologjisë së masave të Strategjisë


Masat	Treguesit kryesorë
<p>Hartimi/Rishikimi i legjislacionit parësor ose dytësor</p> 	<ul style="list-style-type: none"> • Transparenca e procesit të hartimit/ rishikimit • Përfshirja e aktorëve shoqërorë dhe grupeve të interesit në konsultime publike • Përputhja me standardet ndërkombëtare me të cilat synojnë të harmonizohen • Hyrja në fuqi e dispozitave përkatëse
<p>Rritja e kapaciteteve institucionale</p> 	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i kurrikulave dhe planeve të veçanta të trajnimit • Zbatimi praktik i kurrikulave dhe planeve të veçanta të trajnimit • Qëndrueshmëria e ndërtimit të kapaciteteve (përvetësimi i kurrikulave në trajnime të vazhdueshme) • Integrimi i aftësive të reja në përshkrimet e punës dhe në sistemet e vlerësimit të performancës

Fushata publike


- Shtrirja e fushatës dhe përfshirja e audiencës së synuar
- Nivel i angazhimit të audiencës
- Analizat për matjen e efektivitetit dhe impaktit

Integrimi i sistemeve elektronike/ICT

- Transparenca e dizajnit dhe procedurave për ngritjen e sistemit
- Miratimi i planeve për zbatimin e sistemeve ICT
- Implementimi dhe operacionalizimi faktik i sistemeve ICT
- Aksesueshmëria dhe përdorueshmëria për përdoruesit

Strategji/Masa operacionale

- Transparenca e procesit të hartimit/rishikimit
- Përfshirja e aktorëve shoqërorë dhe grupeve të interesit në konsultime publike
- Përputhja me standardet ndërkombëtare me të cilat synojnë të harmonizohen
- Hyrja në fuqi e dispozitave përkatëse

Masa institucionale

- Statusi zyrtar i themelimit të mekanizmave institucionale (akte ligjore, vendime, akte administrative)
- Kapaciteti operativ (rekrutimi i stafit, alokimi i buxhetit)
- Funksonimi efektiv i mekanizmave apo institucioneve të reja

2.3 Burimet e të dhënave dhe klasifikimi i progresit të zbatimit

Procesi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave është mbështetur në kombinimin e shqyrtimit të dokumenteve zyrtare dhe kërkesave për informim drejtuar institucioneve përgjegjëse për zbatimin e masave të Strategjisë.

Procesi i mbledhjes së të dhënave përfshiu shqyrtimin e literaturës dhe dërgimin e 31 kërkesave për informim tek institucionet përgjegjëse, nga të cilat u morën përgjigje nga 19 institucione.

Kryeministria nuk iu përgjigj kërkesës për informim as pas ankimimit te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndërsa Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit njoftuan që informacioni i kërkuar ishte i klasifikuar. Këto kufizime ndikuan në nivelin e detajimit të informacionit të disponueshëm për disa masa të Strategjisë dhe janë marrë parasysh në interpretimin e statusit të zbatimit të tyre.

Nga institucionet që iu përgjigjën kërkesave për informim, disa vunë në dispozicion informacion të përgjithshëm mbi aktivitetet e ndërmarra ose të planifikuara dhe rolin e tyre në zbatimin e Strategjisë, ndërsa të tjerë përcollën dokumentacion mbështetës më të detajuar, si plane pune, strategji institucionale, urdhra për ngritjen e grupeve përkatëse të punës, raporte auditimi si dhe certifikime për menaxhimin e sigurisë së informacionit.

Të dhënat e mbledhura nga shqyrtimi i literaturës dhe nga kërkesat për informim u analizuan me qëllim vlerësimin e statusit të zbatimit të secilës masë, në përputhje me treguesit e përcaktuar.

Duke marrë parasysh fazën e hershme të zbatimit të Strategjisë, vlerësimi i masave u nda në tre kategori:

- masë për të cilën nuk ka nisur zbatimin/nuk ka informacion;
- masë për të cilën ka nisur planifikimi ose zbatimin në fazën e hershme;
- masë e zbatuar.

3. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE I DHE IV TË STRATEGJISË

3.1 Kuadri i masave të parashikuara
në Objektivat I dhe IV

3.2 Institucionet përgjegjëse për
zbatimin dhe koordinimin

3.3 Progresi fillestar i zbatimit të masave

3.4 Gjetjet e monitorimit sipas masave

Ky kapitull paraqet vlerësimin e progresit fillestar të zbatimit të masave të parashikuara nën Objektivin I dhe Objektivin IV të Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030, të cilat lidhen respektivisht me forcimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe adresimin e ndërhyrjeve të huaja në proceset zgjedhore dhe me rritjen e reziliencës së medias dhe shoqërisë ndaj dezinformimit. Vlerësimi mbulon periudhën korrik 2025 – fillim janari 2026 dhe bazohet në analizën e dokumenteve institucionale të disponueshme publikisht, informacionit të siguruar nga institucionet përgjegjëse, si dhe në shqyrtimin e hapave konkretë të ndërmarrë në fazat fillestare të zbatimit të masave përkatëse.


Në vijim, kapitulli paraqet në mënyrë të strukturuar statusin e zbatimit sipas objektivave, tipologjisë së masave dhe institucioneve përgjegjëse, duke evidentuar progresin e arritur, sfidat e hasura dhe boshllëqet kryesore të identifikuar gjatë periudhës së monitorimit.

3.1 Kuadri i masave të parashikuara në Objektivat I dhe IV

Ky seksion paraqet një analizë të kuadrit të masave të parashikuara në Objektivat I dhe IV të Strategjisë, të cilat lidhen respektivisht me forcimin e integritetit të proceseve zgjedhore dhe me rritjen e qëndrueshmërisë së medias dhe shoqërisë ndaj ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimit. Analiza e strukturës së këtyre masave sipas afateve, tipologjisë dhe fushës së ndërhyrjes shërben si bazë për vlerësimin e progresit fillestar të zbatimit të tyre dhe për identifikimin e faktorëve institucionalë që ndikojnë në realizueshmërinë e Strategjisë në këtë fazë të hershme të zbatimit.

Objektivat I dhe IV të Strategjisë përmbajnë gjithsej 28 masa, përkatësisht 19 masa në Objektivin I dhe 9 masa në Objektivin IV. Gjysma e këtyre masave (14 nga 28) nuk kanë një afat të përcaktuar qartë dhe janë referuar si masa “në vijimësi”, ndërsa vetëm 11 masa parashikojnë afate të hershme zbatimi (9–12 muaj). Afatet për pjesën tjetër të masave variojnë midis 15 dhe 24 muajve (shih Figurën 1). Kjo shpërndarje e afateve tregon se një pjesë e konsiderueshme e masave është konceptuar si procese të vazhdueshme institucionale dhe jo si ndërhyrje me rezultate të menjëhershme, çka e bën veçanërisht të rëndësishëm monitorimin e hershëm të progresit institucional dhe të mekanizmave të zbatimit.

Figura 1: Volumi i masave sipas afateve



Për nga tipologjia, masat e parashikuara nën këto dy objektiva përfshijnë ndryshime të legjislacionit parësor dhe dytësor (9 masa), masa strategjike dhe operacionale (5 masa), masa për ngritje kapaciteti dhe burimeve njerëzore (11 masa), fushata publike ndërgjegjësimi (3 masa), pajisje ICT (3 masa) dhe masa institucionale (4 masa) (shih Figurën 2). Kjo shpërndarje reflekton një kombinim ndërhyrjesh normative, organizative dhe ndërgjegjësuese, që synojnë të adresojnë si dimensionin institucional të mbrojtjes së proceseve zgjedhore, ashtu edhe dimensionin shoqëror të qëndrueshmërisë ndaj dezinformimit.

Figura 2: Numri i masave sipas tipologjisë së tyre

Masa për ngritje kapaciteti/Burimet njerëzore	Legjislacion parësor dhe dytësor	Masa strategjike/ Operacionale	Fushata publike
		Masa institucionale	Pajisje ICT
11	9	5	3
		4	3

Të 19 masat e parashikuara nën *Objektivin I "Ngritja dhe konsolidimi i kapaciteteve institucionale për të parandaluar, zbuluar dhe analizuar ndërhyrjet e huaja në fushatat zgjedhore"* përqendrohen në forcimin e mbrojtjes ligjore dhe mekanizmave të monitorimit të proceseve zgjedhore, me qëllim parandalimin dhe adresimin e ndërhyrjeve të huaja.

Këto masa përfshijnë rishikimin dhe përmirësimin e legjislacionit parësor dhe dytësor për proceset zgjedhore, krijimin e një njësie për monitorimin e dezinformimit, hartimin e planeve emergjente kundër sulmeve kibernetike, forcimin e sigurisë së sistemeve TIK zgjedhore, krijimin e platformave digjitale për transparencën e financimeve politike, si dhe rregullimin e ndërhyrjeve të huaja përmes lobimit dhe transparencës së reklamave politike në rrjete sociale gjatë fushatës zgjedhore. Gjithashtu, ky objektivi parashikon masa për forcimin e mbikëqyrjes financiare, rregullimin e veprimtarisë së palëve të treta gjatë fushatave zgjedhore, si dhe koordinimin ndërkombëtar për ndarjen e informacionit mbi kërcënimet hibride. Një pjesë e rëndësishme e masave lidhet edhe me ngritjen e kapaciteteve institucionale, përfshirë trajnime për administratën zgjedhore dhe zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjëse për publikun dhe institucionet arsimore.

Nga ana tjetër, 9 masat e parashikuara nën *Objektivin IV "Mbrojtja dhe forcimi i lirisë së shprehjes dhe medias, dhe rritja e ndërgjegjësimit kundër dezinformimit"* synojnë të forcojnë lirinë e shprehjes dhe medias, si dhe të rrisin aftësitë e qytetarëve për të identifikuar dhe rezistuar ndaj dezinformimit përmes edukimit mediatik dhe digjital.

Këto masa përfshijnë krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile për analizimin dhe monitorimin e ndërhyrjeve të huaja, mbështetjen e tyre me fonde publike, promovimin e gazetarisë së verifikimit të fakteve dhe zhvillimin e programeve trajnuese për gazetarët dhe mbikëqyrësit publik mbi sigurinë digjitale. Gjithashtu, janë parashikuar fushata ndërgjegjëse për publikun, si dhe integrimi i Edukimit për Median dhe Informacionin (EMI) dhe aftësive digjitale në kurrikulat shkollore dhe universitare. Së bashku, masat e parashikuara nën Objektivat I dhe IV adresojnë dimensionet institucionale dhe shoqërore të qëndrueshmërisë ndaj ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimit, duke ndërthurur mbrojtjen e proceseve zgjedhore me forcimin e medias dhe ndërgjegjësimit publik.

3.2 Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe koordinimin

Ky seksion analizon strukturën institucionale përgjegjëse për zbatimin dhe koordinimin e Strategjisë në kuadër të Objektivave I dhe IV, si dhe ndikimin që kanë pasur mekanizmat ekzistues të koordinimit në progresin fillestar të zbatimit të masave të parashikuara.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit” e ushtroi funksionin e tij deri në përfundim të Legjislaturës së X-të të Kuvendit të Shqipërisë. Mandati i këtij komisioni u mbyll me shqyrtimin dhe miratimin e Ligjit Nr. 47/2025 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030”.

Në legjislaturën e re dhe aktuale të Kuvendit të Shqipërisë nuk është parashikuar ngritja e një komisioni të posaçëm për ndërhyrjet e huaja keqdashëse dhe dezinformimin. Si pasojë, është krijuar një boshllëk institucional për mbikëqyrjen parlamentare dhe paqartësi mbi strukturat përgjegjëse të Kuvendit që do të ushtrojnë funksionin e monitorimit.


Strategjia ngarkon Këshillin e Ministrave me hartimin dhe miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë brenda vitit 2025, duke siguruar mbështetje buxhetore për masat dhe investimet e parashikuara. Gjithashtu, Strategjia ngarkon Kuvendin e Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave me krijimin e një strukture të dedikuar për evidentimin dhe përballjen me ndërhyrjet e huaja keqdashëse dhe dezinformimin, strukturë e cila është ngarkuar gjithashtu me përgjegjësi të drejtpërdrejta për zbatimin e një pjese të konsiderueshme të masave të Strategjisë (kryesisht nën Objektivat II dhe III).

Megjithatë, deri në momentin e publikimit të këtij raporti, Plani i Veprimit nuk është miratuar dhe struktura përgjegjëse nuk është krijuar apo përcaktuar. Mungesa e Planit të Veprimit ka penguar fillimin e punës për zbatimin e Strategjisë për të paktën një pjesë të institucioneve përgjegjëse dhe përbën një nga faktorët kryesorë që ka ndikuar në nivelin e kufizuar të progresit të zbatimit gjatë periudhës së monitoruar.

Mungesa e mekanizmave të qartë mbikëqyrës dhe vonesa në krijimin e strukturave përgjegjëse rrezikojnë të dobësojnë zbatimin e Strategjisë. Pa një koordinim të unifikuar dhe përgjegjësi të qarta, ekziston rreziku i shtuar i fragmentimit institucional dhe i ushtrimit të kufizuar të kontrollit parlamentar dhe ekzekutiv.

Për zbatimin e secilës masë, Strategjia përcakton një sërë institucioneve përgjegjëse, ndër të cilat përfshihen Kuvendi, Këshilli i Ministrave, ministritë e linjës, agjenci qeveritare dhe institucione në varësi të qeverisjes qendrore, si edhe disa institucione të pavarura dhe universitete. Siç tregohet në Figurën 3 më poshtë, 24 institucione janë të angazhuara në zbatimin e masave që lidhen me Objektivin I dhe Objektivin IV.


Figura 3: Institucionet e renditura sipas numrit të masave për të cilat janë përgjegjëse



Në përgjigjet e dhëna ndaj kërkesave për informim evidentohet se vetëm 6 nga këto 24 institucione kanë përcaktuar njësi apo zyrtarë përgjegjës për zbatimin e Strategjisë. Konkretisht, në rastin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) përgjegjës është Shefi i Sigurisë së Informacionit; në Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) është ngritur një grup pune prej tre personash për zbatimin e Strategjisë; në Agjencinë e Medias dhe Informacionit (AMI) përgjegjëse është Drejtoria e Informimit të Institucioneve, Hulumtimit dhe Përmbajtjes; në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) Sektori për Çështjet e Sigurisë dhe Diplomacisë Kibernetike pranë Drejtorisë së NATO-s dhe Çështjeve të Sigurisë; në Ministrinë e Drejtësisë (MD) Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë; ndërsa në Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave

Personale (IDPC) Drejtoria për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë. Institucionet e tjera nuk raportuan njësi përgjegjëse ose nuk kishin nisur ende zbatimin e Strategjisë.

Figura 4: Përcaktimi i zyrtarëve/njësive përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë



Megjithatë, përtej përcaktimit formal të strukturave, përgjigjet e disa institucioneve ngrenë pikëpyetje mbi qasjen ndaj zbatimit të Strategjisë. Ministria e Drejtësisë, megjithëse e përfshirë në 11 masa nën Objektivat I dhe IV, theksoi se nuk ka rol kryesor apo iniciativë legjislative për zbatimin e Strategjisë, sipas bazës ligjore që përcakton fushën e saj të përgjegjësisë.

Edhe sipas Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC), masat e Strategjisë për të cilat është ngarkuar nuk i përkasin fushës së veprimtarisë së institucionit të përcaktuar me ligj.

Problematika të ngjashme u evidentuan edhe nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Institucioni argumentoi se mungesa e një vendimi të Këshillit të Ministrave për miratimin e Planit të Veprimit të Strategjisë pamundëson nisjen e zbatimit. Paralelisht, institucioni nënvizoi se nuk mund të përfshihet në çështje që lidhen me proceset apo teknologjitë zgjedhore, të cilat i përkasin KQZ-së si institucion i pavarur, duke qenë se kjo do të binte jashtë kompetencave të tij. Kjo situatë mund të vendosë në pikëpyetje zbatueshmërinë e masave të përbashkëta të parashikuara mes AKSHI-t dhe KQZ-së.

Nga ana tjetër, në kontrast, institucione si Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), KQZ-ja, AMI (edhe pse përgjegjës vetëm për një masë) ose AMSHC-ja raportojnë se kanë ndërmarrë hapa konkretë për zbatimin e Strategjisë, përfshirë hartimin e planeve të punës, alokimin e burimeve financiare, caktimin e personave përgjegjës dhe zhvillimin e aktiviteteve fillestare. Për këto institucione, Strategjia duket se është interpretuar si dokument operacional dhe i zbatueshëm, edhe në mungesë të Planit të Veprimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Ndryshimet e evidentuara në qasjen e institucioneve ndaj zbatimit të Strategjisë, nga interpretimi i saj si dokument operacional deri te trajtimi si angazhim formal apo i kushtëzuar, rrezikojnë të ndikojnë drejtpërdrejt në zbatueshmërinë dhe efektivitetin e saj dhe tregojnë mungesën e një kuadri të unifikuar operacional për zbatimin ndërinstitucional.

Njëkohësisht, numri i lartë i institucioneve të përfshira (24) dhe kompleksiteti i fushës—që ndërthur sigurinë kibernetike, proceset zgjedhore, edukimin mediatik, mbrojtjen e të dhënave, diplomacinë dhe administratën publike—kërkon qartësi të plotë në ndarjen e detyrave, përgjegjësi dhe mekanizme të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Përveç numrit të konsiderueshëm, institucionet janë gjithashtu të ndryshme në natyrë (institucione të pushtetit ekzekutiv dhe administratës qendrore, institucione të pavarura kushtetuese, rregullatore apo arsimore etj.), duke shtuar nevojën për koordinim të strukturuar dhe përcaktim të qartë të roleve.

Pa një harmonizim të qartë midis masave të parashikuara dhe kompetencave ligjore të secilit institucion, ekziston rreziku i shtuar që përgjegjësitë të mbeten të shpërndara, të mbivendosen ose të mos adresohen.

Në këtë kuadër, Plani i Veprimit (ende i pa miratuar deri në momentin e publikimit) nga Këshilli i Ministrave paraqitet si instrument kyç për të adresuar këto problematika. Mungesa e tij deri më tani duket se ka krijuar pasiguri institucionale, interpretime të ndryshme nga institucionet mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe vonesa në nisjen e zbatimit të disa masave. Sipas ligjit për miratimin e Strategjisë, Plani i Veprimit duhet të ishte miratuar në vitin 2025.

3.3 Progresi fillestar i zbatimit të masave

Nga analiza e të dhënave për 28 masat e parashikuara në Objektivat I dhe IV (shih Tabelat 1 dhe 2), rezulton se për pjesën më të madhe të tyre nuk ka nisur ende zbatimi. Konkretisht, për 18 masa, që përbëjnë 64% të totalit, nuk evidentohet progres në zbatim ose mungon informacion i mjaftueshëm për të vlerësuar statusin e tyre. Ndërkohë, 10 masa (36%) rezultojnë në faza të hershme planifikimi ose zbatimit, ndërsa asnjë masë nuk rezulton e zbatuar plotësisht deri në momentin e monitorimit (shih Figurën 5).





-  → Nuk ka nisur zbatimi/nuk ka informacion (18 nga 28, ose 64%)
-  → Në planifikim ose fazë fillestare (10 nga 28, ose 36%)
-  → E zbatuar (0 nga 28)

Figura 5: Shpërndarja e masave sipas statusit të zbatimit



Shumica e masave për të cilat ka nisur planifikimi ose zbatimi në fazat e hershme lidhen me forcimin e kapaciteteve institucionale, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe masat operacionale për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimit.

Nga ana tjetër, shpërndarja e progresit të zbatimit sipas institucioneve përgjegjëse tregon se vetëm një pjesë e kufizuar e institucioneve kanë nisur planifikimin ose zbatimin e masave që u takojnë në kuadër të Strategjisë (Figura 6). Konkretisht, rreth 29% e institucioneve rezultojnë të kenë ndërmarrë hapa fillestarë në drejtim të zbatimit, ndërsa për rreth 71% të institucioneve nuk evidentohet progres i matshëm gjatë periudhës së monitorimit. Ky raport pasqyron karakterin ndërsektorial të Strategjisë dhe varësinë e zbatimit të saj nga mekanizma të koordinimit ndërinstitucional që janë ende në faza të hershme zhvillimi.

Figura 6: Progresi i zbatimit sipas institucioneve përgjegjëse





Figura 7 tregon se progresi fillestar i zbatimit është përqendruar kryesisht në masat që lidhen me ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore, si dhe në masa strategjike dhe operacionale, ndërsa masat që kërkojnë ndryshime në legjislacionin parësor dhe dytësor, krijimin e infrastrukturave të reja digjitale dhe mekanizmave të rinj institucionalë rezultojnë në pjesën më të madhe të pazbatuara. Kjo shpërndarje konfirmon se ndërhyrjet që kërkojnë koordinim ndërinstitucional dhe procese më të gjata vendimmarrëse zakonisht avancojnë me ritme më të ngadalta në fazat e hershme të zbatimit të Strategjisë.

Figura 7: Statusi i zbatimit sipas tipologjisë së masës



Progresi fillestar në masat që lidhen me integritetin e proceseve zgjedhore

Në fushën e mbrojtjes së proceseve zgjedhore dhe forcimit të kapaciteteve institucionale kundër ndërhyrjeve të huaja, disa institucione kanë ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të zbatimit të masave të parashikuara, veçanërisht në drejtim të forcimit të sigurisë së sistemeve zgjedhore, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe koordinimit ndërkombëtar për adresimin e kërcënimeve hibride.

Në kuadër të **Masës 1.1** mbi përforcimin e mbrojtjes ligjore dhe mekanizmave të monitorimit të proceseve zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar dokumente strategjike për menaxhimin e sigurisë së informacionit, si dhe protokolle për reagimin dhe rikuperimin në rast incidentesh. Gjithashtu, për sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) që përdoren në proceset zgjedhore janë zhvilluar auditime të sigurisë dhe testime të penetrimit (audit-pentest), të cilat përfaqësojnë hapa të rëndësishëm drejt forcimit të sigurisë teknike të infrastrukturës zgjedhore.

Në kuadër të **Masës 1.3** mbi forcimin e përgjegjësisë dhe koordinimit ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë për parandalimin e ndërhyrjeve të huaja, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka hartuar dhe miratuar Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030, e cila trajton edhe kërcënimet hibride dhe bashkërendimin institucional për parandalimin, zbulimin dhe reagimin ndaj tyre.

Në nivel të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në kuadër të **Masës 1.3.4** mbi ndërveprimin me struktura ndërkombëtare dhe qendra ekspertize për ndërhyrjet e huaja, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka ndërmarrë hapa për forcimin e koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht me NATO-n dhe Bashkimin Evropian. Shembuj të këtij bashkëpunimi përfshijnë angazhimin me Qendrën Evropiane të Ekselencës ndaj Kërcënimeve Hibride (Hybrid CoE), si dhe pjesëmarrjen në mekanizma dhe grupe pune të NATO-s për kundërveprimin ndaj dezinformimit, si NATO Rapid Response Group (NRRG). Edhe Agjencia për Media dhe Informim informoi për përfshirjen e saj në mekanizma të bashkëpunimit ndërkombëtar të NATO-s si NRRG dhe NRRG Signal Group.

Gjithashtu, në kuadër të masave që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale në kontekstin e sigurisë zgjedhore, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar 10 akte nënligjore për zbatimin e Ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, në përputhje me kërkesat e **Masës 1.4.2** mbi përmirësimin e rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave personale.

Megjithatë, përtej këtyre hapave fillestarë në forcimin e sigurisë institucionale dhe koordinimit ndërkombëtar, një pjesë e masave që lidhen drejtpërdrejt me transparencën e financimeve politike dhe mbikëqyrjen e fushatave zgjedhore mbeten ende të pazbatuara, duke përbërë një nga boshllëqet kryesore në kuadrin e integritetit zgjedhor.

Në këtë kuadër, përfshirja e transparencës së financimeve politike, rregullimit të rolit të palëve të treta dhe mbikëqyrjes së reklamave politike në rrjetet sociale në [kalendarin e punës](#) së Komisionit të Reformës Zgjedhore përbën një zhvillim pozitiv, i cili krijon një mundësi konkrete për harmonizimin e kuadrit ligjor zgjedhor me masat e parashikuara në Strategji dhe për adresimin e boshllëqeve të evidentuara gjatë monitorimit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025.

Progresi fillestar në masat që lidhen me median, edukimin mediatik dhe ndërgjegjësimin publik

Në krahasim me masat që lidhen me reformimin e kuadrit ligjor zgjedhor dhe transparencën e financimeve politike, një pjesë e masave të parashikuara nën Objektivin IV që lidhen me edukimin mediatik dhe ndërgjegjësimin publik rezultojnë në faza fillestare zbatimi, kryesisht nëpërmjet aktiviteteve institucionale me karakter informues, mbështetës dhe ndërgjegjëses.

Në këtë kuadër, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka hartuar një plan institucional për zbatimin e Strategjisë, i cili parashikon mbështetje financiare për organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e luftës kundër dezinformimit. Sipas këtij plani, rreth 10% e buxhetit të thirrjeve publike të institucionit do të dedikohet për projekte që lidhen me këtë fushë, në përputhje me **Masën 4.1.2** të Strategjisë.

Në fushën e arsimit dhe ndërgjegjësimin publik, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka ndërmarrë hapa për integrimin gradual të Edukimit për Median dhe Informacionin (EMI) dhe aftësive digjitale në kurrikulat shkollore, në përputhje me kërkesat e **Masës 4.2.2**. Këto ndërhyrje përfaqësojnë hapa fillestarë drejt institucionalizimit të edukimit mediatik në sistemin arsimor, megjithëse zbatimi i plotë i tyre kërkon zhvillimin e mëtejshëm të moduleve mësimore, trajnimin e mësuesve dhe koordinimin ndërinstitucional për integrimin sistematik të kompetencave të EMI-t në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Ndërkohë, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka ndërmarrë një sërë aktivitete informuese dhe ndërgjegjëse në funksion të rritjes së edukimit mediatik dhe promovimit të përdorimit të përgjegjshëm të medias audiovizive dhe platformave digjitale, të cilat lidhen kryesisht me **Masat 4.2.1** dhe **4.2.3** të Objektivit IV të Strategjisë. Në veçanti, AMA ka publikuar materiale informuese dhe udhëzuese për publikun mbi fenomenet e dezinformimit, manipulimit online, gjuhës së urrejtjes dhe sfidave që lidhen me zhvillimet e inteligjencës artificiale, si pjesë e mandatit të saj për promovimin e informacionit të besueshëm dhe mbrojtjen e publikut nga përmbajtjet e dëmshme në hapësirën audiovizive.

Gjithashtu, sipas raportimeve institucionale të AMA për periudhën korrik 2025 – janar 2026, janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjëse dhe komunikimi publik në funksion të rritjes së ndërgjegjësimin mbi sigurinë në internet, përdorimin kritik të medias dhe identifikimin e përmbajtjeve manipuluese, si dhe janë vijuar aktivitetet e monitorimit të përmbajtjeve audiovizive në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe standardet e etikës së transmetimit, në përputhje me **Masën 4.1.4** të Strategjisë. Këto ndërhyrje përfaqësojnë hapa fillestarë në drejtim të promovimit të informacionit të besueshëm dhe forcimit të reziliencës së publikut ndaj dezinformimit, megjithëse krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm dhe të strukturuar ndërinstitucionalë për adresimin e dezinformimit, në përputhje me **Masën 4.1.1**, mbetet ende në faza të hershme zhvillimi.

Megjithatë, pavarësisht këtyre hapave fillestarë, një pjesë e masave të parashikuara nën Objektivin IV që lidhen me krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm bashkëpunimi ndërinstitucional, mbështetjen sistematike të gazetarisë së verifikimit të fakteve dhe zhvillimin e programeve të strukturuar kombëtare për edukimin mediatik mbeten ende në faza të hershme planifikimi dhe kërkojnë koordinim më të gjerë institucional dhe burime të dedikuara për zbatimin e tyre të plotë.

Masat për të cilat nuk ka nisur ende zbatim

Pjesa më e madhe e masave për të cilat nuk ka nisur ende zbatim lidhen me ndryshime në legjislacionin zgjedhor parësor dhe dytësor, forcimin e transparencës së financimeve politike dhe krijimin e mekanizmave të rinj institucionalë për monitorimin dhe reagimin ndaj ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimit.

Masat legjislative të pazbatuara lidhen kryesisht me rregullimin e financimeve dhe transparencës në fushatat zgjedhore, përfshirë amendimin e kuadrit ligjor zgjedhor për të parandaluar financimet nga burime të dyshimta dhe për të adresuar fushatat "hije", si dhe miratimin e dispozitave të qarta për ndalimin dhe monitorimin e financimeve të huaja për partitë politike dhe kandidatët zgjedhorë.

Në veçanti, **Masa 1.2.2**, e cila parashikon krijimin e një platforme digjitale për regjistrimin në kohë reale të burimeve financiare dhe shpenzimeve të partive politike, nuk është zbatuar sipas parashikimeve të Strategjisë. Megjithëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve disponon një platformë ekzistuese për raportimin financiar, ajo nuk u përmirësua në kohë për dorëzimin e raporteve financiare të fushatës për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, duke sjellë vështirësi në përdorim nga subjektet raportuese dhe [kufizime në transparencën](#) e të dhënave për publikun dhe median.

Gjetje të ngjashme janë evidentuar edhe nga analiza e pavarur e raporteve financiare të subjekteve zgjedhore, të cilat tregojnë mangësi strukturore në mekanizmat ekzistues të mbikëqyrjes financiare dhe theksojnë rëndësinë e zbatimit të **Masës 1.2.5** për fuqizimin e kapaciteteve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rishikimin e mekanizmave për monitorimin e financave të partive politike. Këto mangësi janë veçanërisht të theksuara në raportimin dhe monitorimin e shpenzimeve të fushatës në rrjetet sociale, çështje që lidhen drejtpërdrejt edhe me **Masën 1.3.2** mbi vendosjen e rregullave të qarta për [transparencën financiare të reklamave politike online](#) gjatë fushatave zgjedhore.

Po ashtu, nuk ka nisur ende zbatim i masave që lidhen me regjistrimin dhe deklarimin e burimeve financiare dhe lidhjeve me palë të treta gjatë fushatave zgjedhore, si dhe krijimin e databazave publike të aksesueshme për deklarimet përkatëse, të cilat përbëjnë elementë thelbësorë për rritjen e transparencës dhe identifikimin e ndërhyrjeve të mundshme të huaja në proceset zgjedhore.

Ndër masat legjislative të parashikuara për rregullimin e veprimtarisë lobuese, megjithëse është miratuar një ligj përkatës në janar 2026, ai nuk adreson ndërhyrjen e huaj sipas kërkesave të Strategjisë dhe për këtë arsye është vlerësuar si masë e pazbatuar në kuadër të objektivave të saj.

Gjithashtu, nuk ka nisur ende zbatimi i masave për krijimin e regjistrit kombëtar për transparencën e aktiviteteve të lobimit dhe platformave të integruara për publikimin në kohë reale të të dhënave mbi financimet politike dhe aktivitetet e palëve të treta, të cilat synojnë rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së ndikimit në proceset zgjedhore.

Ndër masat institucionale të pazbatuara përfshihen krijimi i një njësie të dedikuar për monitorimin e dezinformimit dhe reagimin në kohë reale ndaj tij, si dhe krijimi i mekanizmave të strukturuar të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për adresimin e ndërhyrjeve të huaja informative dhe organizatave të shoqërisë civile.

Gjithashtu, disa masa të rëndësishme për ngritjen e kapaciteteve që lidhen me median dhe administratën publike nuk kanë nisur ende zbatimin, përfshirë zhvillimin e programeve të strukturuar trajnuese për gazetarët dhe mbikëqyrësit publik mbi sigurinë digjitale dhe identifikimin e dezinformimit, organizimin e trajnimeve për administratën zgjedhore mbi rreziqet e ndërhyrjeve hibride në proceset zgjedhore, si dhe integrimin e moduleve të detyrueshme të trajnimit mbi edukimin mediatik dhe sigurinë digjitale në programet e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).

Në tërësi, mungesa e progresit në këto masa reflekton faktin se një pjesë e konsiderueshme e ndërhyrjeve të parashikuara nga Strategjia kërkojnë ndryshime të koordinuara ligjore dhe institucionale, si dhe burime të dedikuara njerëzore dhe teknike, të cilat zakonisht kërkojnë kohë më të gjatë për t'u planifikuar dhe zbatuar. Megjithatë, këto masa mbeten thelbësore për forcimin e integritetit të proceseve zgjedhore dhe rritjen e reziliencës institucionale dhe shoqërore ndaj ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimit.

3.4 Gjetjet e monitorimit sipas masave

Në vijim paraqiten në mënyrë të strukturuar gjetjet kryesore të monitorimit për statusin e zbatimit të masave të parashikuara në Objektivat I dhe IV të Strategjisë, të organizuara sipas fushave të ndërhyrjes dhe institucioneve përgjegjëse. Tabelat sintetizojnë vlerësimin e nivelit të progresit për secilën masë individuale, bazuar në analizën e dokumenteve institucionale, informacionit publik të disponueshëm dhe komunikimit me institucionet përgjegjëse gjatë periudhës korrik 2025 – janar 2026.

Statusi i zbatimit është paraqitur përmes një sistemi kodimi me ngjyra, i cili dallon masat për të cilat nuk evidentohet progres në zbatim ose mungon informacion i mjaftueshëm për vlerësim, masat që rezultojnë në faza planifikimi ose zbatimi fillestar, si dhe masat për të cilat evidentohet progres më i avancuar. Kjo paraqitje synon të ofrojë një pasqyrë të qartë krahasuese mbi nivelin aktual të zbatimit të Strategjisë dhe të identifikojë fushat prioritare që kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme institucionale.

Tabela 2 paraqet statusin e zbatimit për masat e parashikuara nën Objektivin I, që lidhen me ngritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin, zbulimin dhe analizimin e ndërhyrjeve të huaja në fushatat zgjedhore, ndërsa Tabela 3 paraqet statusin e masave të parashikuara nën Objektivin IV, që lidhen me forcimin e reziliencës së medias dhe shoqërisë ndaj dezinformimit dhe ndërhyrjeve të huaja informative.

Tabela 2: Statusi i zbatimit të masave të Objektivit I “Ngritje dhe konsolidim i kapaciteteve institucionale për të parandaluar, zbuluar dhe analizuar ndërhyrjet e huaja në fushatat zgjedhore”

Fusha	Masa	Afati	Institucionet përgjegjëse	Lloji i masës	Statusi i zbatimit
1.1 Përforcimi i mbrojtjes ligjore dhe mekanizmave të monitorimit të proceseve zgjedhore	1.1.1 Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor	15 muaj	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ministria e Drejtësisë	Legjislacion parësor	Red
				Legjislacion dytësor	Red
	1.1.2 Një kuadër rregullator për vlerësimin paraprak dhe auditues për sistemet TIK në proceset zgjedhore. Auditimi dhe certifikimi i databazave të zgjedhësve dhe pajisjeve zgjedhore.	15 muaj	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ministria e Brendshme, AKSK, AKSHI, Kontrolli i Lartë i Shtetit	Legjislacion parësor	Red
				Strategji/ Masa operacionale	Yellow
				Strategji/ Masa operacionale	Red
				Strategji/ Masa operacionale	Red
	1.1.3 Hartimi i një plani emergjent për reagimin ndaj sulmeve kibernetike	12 muaj	KQZ, MM, MB, AISM, SHISH, AKSK, AKSHI, KDIMDHP	Strategji/ Masa operacionale	Red
				Në vijimësi	Ngritje kapaciteti/ Burime njerëzore

1.2 Rritja e transparencës dhe krijimi i mekanizmave për mbikëqyrjen e financimeve politike	1.2.1 Hartimi i legjislacionit për ndalimin e financimeve të huaja	12 muaj	Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Legjislacion parësor	
	1.2.2 Krijimi i një platforme digjitale për transparencë financiare	12 muaj	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ministria e Drejtësisë	Pajisje ICT	
	1.2.3 Miratimi i kuadrit rregullator për veprimtarinë lobuese	24 muaj	Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, MAPA, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Legjislacion parësor	
	1.2.4 Ngritja e një regjistri kombëtar për transparencën e aktiviteteve të lobimit	24 muaj	Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, MAPA, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Pajisje ICT	
	1.2.5 Fuqizimi i mbikëqyrjes financiare	Në vijimësi	Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Ngritje kapaciteti/ Burime njerëzore	
	1.2.6 Angazhimi në programe ndërkombëtare në fushën e sigurisë mbi proceset zgjedhore	Në vijimësi	MEPJ, AKSHI, AKSK, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Ngritje kapaciteti/ Burime njerëzore	
	1.2.7 Rregullimi i veprimtarisë të palëve të treta në fushatat zgjedhore	12 muaj	Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, KDIMDHP	Legjislacion dytësor	
				Pajisje ICT	

1.3 Forcimi i përgjegjësisë dhe koordinimi ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë për parandalimin e ndërhyrjeve të huaja	1.3.1 Krijimi i një njësie të dedikuar për monitorimin e dezinformimit	12 muaj	Kuvendi, Komisioni përgjegjës Parlamentar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ministria e Drejtësisë	Masa institucionale	
	1.3.2 Rregullime për transparencën financiare të reklamave politike në rrjete sociale gjatë fushatës zgjedhore	12 muaj	Ministria e Drejtësisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Autoriteti i Mediave Audiovizive	Legjislacion parësor	
	1.3.3 Koordinimi ndërkombëtar për ndarjen e informacionit mbi kërcënimet hibride dhe/ ose ndërhyrjet e huaja	Në vijimësi	MEPJ, MM, AKSHI, AKSK, etj.	Masa institucionale	
	1.3.4 Ndërveprimi me struktura ndërkombëtare dhe qendra ekspertize për ndërhyrjet e huaja	Në vijimësi	MEPJ, MM, KQZ	Masa institucionale	
1.4 Sanksionimi i ndërhyrjeve të huaja dhe forcimi i kuadrit ligjor	1.4.1 Kuadër rregullator për financimet e paligjshme dhe ndërhyrjet e huaja, në proceset zgjedhore	12 muaj	Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, AKSK	Legjislacion parësor	
	1.4.2 Përmirësimi i rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave personale	9 muaj	KDIMDHP, MD, MB, KQZ, AKSK	Legjislacion parësor	

1.5 Ndërtimi i kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimi publik	1.5.1 Organizimi i trajnimeve për administratën zgjedhore	12 muaj	KQZ, Institucionet e reja të fushës	Ngritje kapaciteti/ Burime njerëzore	
		Në vijimësi		Ngritje kapaciteti/ Burime njerëzore	
	1.5.2 Fushata ndërgjegjësuese për qytetarët	Në vijimësi	KQZ, AMSHC, SASPAC, OSHC, Institucione të reja të fushës	Fushata publike	
	1.5.3 Fushata ndërgjegjësimi me institucionet e arsimit të lartë	Në vijimësi	Ministria e Arsimit, Universitetet, Institucionet e reja të fushës	Fushata publike	

Tabela 3: Statusi i zbatimit të masave të Objektivit IV “Mbrojtja dhe forcimi i lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit publik kundër dezinformimit”

Fusha	Masa	Afati	Institucionet përgjegjëse	Lloji i masës	Statusi i zbatimit
4.1 Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të pavarura për të luftuar dezinformimin	4.1.1 Krijimi i mekanizmave të strukturuar të bashkëpunimit midis institucioneve që trajtojnë FIMI-n dhe OJF-ve, duke mundësuar analizimin dhe monitorimin e ndërhyrjes së huaj	12 muaj	Kuvendi, Këshilli i Ministrave, AMSHC, Struktura përgjegjëse	Masa institucionale	
	4.1.2 Mbështetja me fonde publike e programeve dhe zhvillimit të kapaciteteve për OJF-të për të zhvilluar ekspertizë në kërkimin, analizën dhe zbulimin e FIMI-t, si edhe në advokim, rritje ndërgjegjësimit	Në vijimësi	Kuvendi, Këshilli i Ministrave, AMSHC, AMA, AMI	Ngritje kapaciteti/ Burime njerëzore	
	4.1.3 Promovimi i gazetarisë të verifikimit të fakteve në transmetimet e medias publike (RTSH) dhe mediat ndërkombëtare	Në vijimësi	Kuvendi, AMA, RTSH	Ngritje kapaciteti/ Burime njerëzore	

4.1 Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të pavarura për të luftuar dezinformimin	4.1.4 Zhvillimi i programeve trajnuese dhe i mekanizmave mbështetës për gazetarët, mediat, mbikëqyrësit publik mbi sigurinë digjitale	Në vijimësi	Këshilli i Ministrave, AMA, AKSK, AMSHC, Departamenti i Gazetarisë, IAL	Ngritje kapaciteti/ Burime njerëzore	
	4.1.5 Mundësimi i lehtësirave fiskale për Gazetarinë Investigative për të forcuar pluralizmin mediatik dhe për të luftuar dezinformimin e mbështetur nga aktorë të huaj	24 muaj	Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, DPT	Ngritje kapaciteti/ Burime njerëzore	
4.2 Promovimi i informacionit të besueshëm, rritja e ndërgjegjësimit e edukimit mediatik, si edhe fuqizimi i aftësive digjitale të qytetarëve, me qëllim forcimin e rezistencës shoqërore ndaj dezinformimit	4.2.1 Publikimi në mënyrë të dukshme i politikave editoriale dhe standardet për moderimin e përmbajtjes në media, duke i dhënë audiencës mundësinë të kuptojë qartë proceset e përzgjedhjes së lajmeve dhe verifikimit të fakteve	12 muaj	AMA, Organizatat e profesionistëve të fushës, Departamenti i Gazetarisë, IAL	Strategji/ Masa operacionale	

4.2 Promovimi i informacionit të besueshëm, rritja e ndërgjegjësimit e edukimit mediatik, si edhe fuqizimi i aftësive digjitale të qytetarëve, me qëllim forcimin e rezistencës shoqërore ndaj dezinformimit	4.2.2 Përfshirja e Edukimit për Median dhe Informacionin (EMI), së bashku me aftësitë digjitale, në kurrikulat e shkollave parauniversitare dhe universitare	24 muaj	Këshilli i Ministrave, Ministria e Arsimit, AMA, IAL, Qeveria e Nxënësve, Bordi i Prindërve	Strategji/ Masa operacionale	
	4.2.3 Zbatimi i fushatave të gjera ndërgjegjësuese për publikun, të përqëndruara në identifikimin e taktikave të dezinformimit dhe nxitjen e mendimit kritik të qytetarët, për të forcuar qëndrueshmërinë ndaj FIMI-t	Në vijimësi	Këshilli i Ministrave, Ministria e Arsimit, AMA, IAL, Organizatat e profesionistëve të fushës	Ngritje kapaciteti/ Burime njerëzore- Fushata publike	
	4.2.4 Krijimi i moduleve të detyrueshme të trajnimit mbi EMI dhe sigurinë digjitale në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)	24 muaj/Në vijimësi	MAPA, AKSK, AMA, ASPA	Ngritje kapaciteti/ Burime njerëzore	

4. KONKLUSIONE

Gjetjet e monitorimit të gjashtëmujorit të parë të zbatimit të Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030 tregojnë se zbatimi praktik i masave mbetet në një fazë shumë të hershme zhvillimi. Nga 28 masat e analizuara nën Objektivat I dhe IV, asnjë nuk rezultoi e zbatuar plotësisht deri në momentin e monitorimit, ndërsa për 64% të tyre nuk evidentohet progres i matshëm ose mungon informacion i mjaftueshëm për vlerësim. Vetëm 36% e masave rezultojnë në faza fillestare planifikimi ose zbatimi.

Progresi i vërejtur është përqendruar kryesisht në masa që lidhen me forcimin e kapaciteteve institucionale, koordinimin ndërinstitucional dhe ndërveprimin me partnerët ndërkombëtarë në fushën e sigurisë kibernetike dhe kërcënimeve hibride. Nga ana tjetër, masat që kërkojnë ndërhyrje në legjislacionin parësor dhe dytësor zgjedhor, zhvillimin e infrastrukturave të reja digjitale për transparencën e financimeve politike, krijimin e mekanizmave të rinj institucionalë për monitorimin e ndërhyrjeve të huaja informative dhe mbështetjen e strukturuar të edukimit mediatik mbeten në pjesën më të madhe të pazbatuara.

Një nga gjetjet kryesore të monitorimit lidhet me mungesën e një kuadri të qartë dhe të konsoliduar të koordinimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të Strategjisë. Mbyllja e mandatit të Komisionit të Posaçëm parlamentar dhe mungesa e një strukture të dedikuar për mbikëqyrjen parlamentare të Strategjisë në legjislaturën aktuale ka krijuar një boshllëk institucional në nivelin e monitorimit politik dhe strategjik të zbatimit të saj.

Në të njëjtën kohë, struktura e dedikuar për evidentimin dhe reagimin ndaj ndërhyrjeve të huaja informative dhe dezinformimit, e parashikuar në Strategji si mekanizëm koordinues ndërinstitucional, nuk është krijuar ende. Mungesa e këtij mekanizmi kufizon mundësinë për koordinim sistematik ndërmjet institucioneve përgjegjëse në fusha që ndërthuren drejtpërdrejt me sigurinë zgjedhore, sigurinë kibernetike, median dhe edukimin publik.

Një faktor tjetër që ka ndikuar në ritmin e zbatimit lidhet me mosmiratimin ende të Planit të Veprimit nga Këshilli i Ministrave, megjithëse miratimi i tij ishte parashikuar brenda vitit 2025. Mungesa e këtij dokumenti ka krijuar pasiguri institucionale mbi rolet konkrete zbatuese dhe afatet e realizimit të masave, duke sjellë interpretime të ndryshme ndërmjet institucioneve përgjegjëse për karakterin operacional të Strategjisë. Në këtë kontekst, rreth 70% e institucioneve të ngarkuara me përgjegjësi në kuadër të Strategjisë nuk kanë raportuar nisjen e veprimeve konkrete për zbatimin e masave përkatëse gjatë periudhës së monitorimit.

Kompleksiteti i fushës së ndërhyrjeve të huaja informative dhe dezinformimit, e cila ndërthur komponentë të sigurisë kibernetike, proceseve zgjedhore, lirisë së medias, edukimit mediatik, mbrojtjes së të dhënave personale dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, kërkon mekanizma të qartë koordinimi horizontal ndërinstitucional dhe harmonizim të masave me kompetencat ligjore ekzistuese të institucioneve përgjegjëse. Përfshirja e një numri të lartë institucionesh në zbatimin e Strategjisë e bën të domosdoshme qartësimin e përgjegjësive funksionale dhe krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm bashkëpunimi.

Megjithëse zbatimi i Strategjisë do të vijojë deri në vitin 2030 dhe rezultatet më të matshme pritet të bëhen të dukshme në fazat e mëvonshme të implementimit, zhvillimet e vitit të parë mbeten përcaktuese për krijimin e bazës institucionale të zbatimit dhe për besueshmërinë afatgjatë të mekanizmave të parashikuar në të.

5. REKOMANDIME

Gjatë vitit të parë të zbatimit (2025–2026), prioriteti kryesor duhet të jetë krijimi i bazës institucionale dhe procedurale për zbatimin efektiv dhe të koordinuar të Strategjisë.

Në këtë kuadër, Këshilli i Ministrave duhet të prioritetizojë hartimin dhe miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë, duke përcaktuar qartë afatet konkrete të realizimit të masave, treguesit e vlerësimit të progresit dhe mekanizmat e raportimit periodik ndërinstytucional. Miratimi i këtij dokumenti është thelbësor për harmonizimin e interpretimit institucional të rolit të Strategjisë dhe për kalimin nga një fazë orientuese strategjike në një fazë operacionale zbatimi.

Krahas kësaj, është i nevojshëm krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm koordinimi ndërinstytucional për adresimin e ndërhyrjeve të huaja informative dhe dezinformimit, në përputhje me parashikimet e Strategjisë. Ky mekanizëm duhet të mundësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të reagimit të koordinuar ndaj rreziqeve që lidhen me integritetin e proceseve zgjedhore dhe sigurinë e informacionit publik.

Gjithashtu, është e rëndësishme të rivendoset një mekanizëm efektiv i mbikëqyrjes parlamentare për zbatimin e Strategjisë, përmes raportimeve periodike institucionale dhe diskutimeve të strukturuar në komisionet parlamentare përkatëse. Mbikëqyrja parlamentare përbën një element thelbësor për garantimin e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e zbatimit të masave strategjike me karakter ndërsektorial.

Në planin sektorial, rekomandohet që institucionet përgjegjëse të prioritetizojnë zbatimin e masave që lidhen drejtpërdrejt me integritetin e proceseve zgjedhore, përfshirë zhvillimin e platformave digjitale për transparencën e financimeve politike, përmirësimin e mekanizmave të mbikëqyrjes së shpenzimeve të fushatave zgjedhore, si dhe rregullimin e transparencës së reklamave politike në mjedisin online dhe rolit të palëve të treta gjatë fushatave zgjedhore.

Paralelisht, është e nevojshme të përshpejtohet zhvillimi i programeve të strukturuar kombëtare për edukimin mediatik dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi dezinformimin, si dhe të forcohen mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet institucioneve publike, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile në këtë fushë.

Së fundi, sigurimi i mbështetjes së qëndrueshme buxhetore për zbatimin e Strategjisë dhe për zhvillimin gradual të kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës teknologjike përbën një kusht thelbësor për arritjen e objektivave të saj dhe për rritjen e reziliencës institucionale dhe shoqërore ndaj ndërhyrjeve të huaja informative dhe dezinformimit në periudhat zgjedhore dhe përtej tyre.



Zbatimi i Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit:

Integriteti zgjedhor, qëndrueshmëria e
medias dhe ndërgjegjësimi publik

Vlerësim për Objektivat I dhe IV në 6 muajt e parë të zbatimit



© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri
(Balkan Investigative Reporting Network Albania - BIRN)
Tiranë, 2026